

VENDIM
Nr. 912, datë 21.12.2016

**PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR DOM ERNEST
SIMONI TROSHANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror Dom Ernest Simoni Troshani, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi